

VENDIM
Nr.7, datë 26.1.2009

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË ZBATIMIT TË TARIFAVE TË SHËRBIMIT DHE
ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË DHE SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.87, datë 6.8.2008 “Për miratimin e deklaratës rregullatore në kuadër të zbatimit të metodologjive të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.1.2009, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve, lidhur me shtyrjen e afatit të zbatimit të tarifave të shërbimit të energjisë elektrike, të çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë, të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et ekzistuese (private apo të dhëna me koncesion) me fuqi të instaluar deri në 10 MW dhe të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW,

konstatoi se:

- Ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, përcakton ERE-n, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për vendosjen e tarifave të energjisë elektrike për të gjitha veprimtaritë e rregulluara.

- Me vendimin nr.87, datë 6.8.2008 “Për miratimin e deklaratës rregullatore në kuadër të zbatimit të metodologjive të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi, ndër të tjera, ka vendosur ngrirjen e tarifave dhe çmimeve të shitjes së energjisë elektrike.

- Me vendimin nr.87, datë 16.1.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, Këshilli i Ministrave ndër të tjera ka shtuar fuqinë e instaluar nga 10 MW në 15 MW për HEC-et e rinj.

Për të gjitha sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyhet afati i zbatimit të tarifave të shërbimit të energjisë elektrike, të çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë, të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et ekzistuese (private apo të dhëna me koncesion) me fuqi të instaluar deri në 10 MW dhe të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW.

2. Lënien në fuqi deri më datë 31.12.2009 të vendimeve të Bordit të Komisionerëve, si më poshtë:

- Vendimi nr.82, datë 24.12.2007 “Për përcaktimin e shitjes së energjisë elektrike nga HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2008”;

- Vendimi nr.18, datë 14.2.2008 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për periudhën 1 mars 2008-28 shkurt 2009”;

- Vendimi nr.19, datë 14.2.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për periudhën 1 mars 2008-28 shkurt 2009”.

- Vendimi nr.20, datë 14.2.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes, për periudhën 1 mars 2008-28 shkurt 2009”;

- Vendimi nr.21, datë 14.2.2008 “Për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për konsumatorët tariforë për periudhën 1 mars 2008-28 shkurt 2009”;

- Vendimi nr.22, datë 14.2.2008 “Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 10

MW për periudhën 1 mars 2008-28 shkurt 2009”.

- Vendimi nr.75, datë 26.6.2008 “Për përcaktimin e çmimit të shitjes me shumicë të energjisë elektrike nga FPSH për periudhën 1 korrik 2008-28 shkurt 2009”.

3. Efektet e shkaktuara nga lënia në fuqi e vendimeve të mësipërme, për të gjithë përbërësit e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike, do të kompensohen në çmimet dhe tarifat e shërbimeve të energjisë elektrike për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta